



Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 18

Prishtinë, më 6.3.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Nezir Çoçaj, Igor Simiq dhe Bilall Sherifi.

Munguan: Glauk Konjufca, Sami Kurteshi dhe Shkumbin Demaliaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Pajtim Çuni, RTK; Sylë Ahmeti, “Kosova sot”; Shkëlzen Maliqi, Nehat Idrizi, Agim Maliqi, Muhamet Kurtishaj, Vehbi Behluli, Hazir Lushaj dhe Ajshe Berisha, KGJK; Albert Krasniqi, KDI; Kushtrim Kadriu, KTV dhe Blerta Bejtullahu, EUSR/EV.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më datë 23.1 dhe 30.1.2018;
3. Adresimi i kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, lidhur me sistemin gjyqësor të Kosovës;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës;
5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-034 për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për nr. 04/L-034 për Agjencinë

Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 05/L-080;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më dt. 23.1. dhe 30.1.2018

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më dt. 23.1 dhe 30.1.2018, pa vërejtje.

3. Adresimi i kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, lidhur me sistemin gjyqësor të Kosovës

Kryetarja, tha se sot kemi si pikë të rendit të ditës, adresimin e kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, lidhur me sistemin gjyqësor në Republikën e Kosovës, gjegjësisht për problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe sistemi gjyqësor në përgjithësi. Vërejtja e saj ishte se në raport të punës për vitin 2017, nuk kishte fare rekomandime konkrete që i drejtohen Kuvendit të Kosovës, gjegjësisht Komisionit për Legjislacion, në mënyrë që komisioni ta ketë më të qartë se cilat janë sfidat dhe problemet që ka Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe e ftoi z. Nehat Idrizi, që të marrë fjalën.

Nehat Idrizi, tha se është hera e parë që paraqitem pranë komisionit dhe në shenjë respekti që kemi për këtë komision, dhe për shkak të bashkëpunimit dhe shumë punë që na lidhin, sidomos sa i përket sferës së legjislacionit, ne me kënaqësi e kemi pranuar ftesën, pavarësisht të metave që mund të kemi, por rezultatet, sfidat e rekomandimet që i kemi, t'i ndajmë së bashku. Aktualisht, nga 13 anëtarë, sa duhet t'i ketë Këshilli Gjyqësor i Kosovës, i ka 11 anëtarë. Sa i përket obligimit kushtetues nga përfaqësimi i komuniteteve, janë të përfaqësuara katër prej tyre, sa i parasheh Kushtetuta, dy nga komuniteti serb, një nga komuniteti boshnjak dhe një nga komuniteti rom. Sa i përket përfaqësimit gjinor, aktualisht nga 11 anëtarë, katër janë të gjinisë femërore. Këshilli Gjyqësor ka komisionet e rregullta, të cilat i ndihmojnë KGJK-së, në punën e tij. Kemi komisione për çështje normative, komisione për buxhet, financa dhe personel, komisioni për administrimin e gjykatave, komisioni disiplinor, si dhe komisionin për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve. Vitin e kaluar ka qenë një proces i rrugëtimit të gjyqtarëve, përzgjedhja e kryetarit të Gjykatës, si dhe integrimi i veriut. Sa i përket procesit të integritetit të veriut, ky proces është kryer me të gjitha obligimet që dalin nga marrëveshja e Brukselit, e kemi përmbushur me kohë, dhe aktualisht, ajo gjykatë funksionon si gjykatë unike dhe deri në këtë fazë nuk kemi pasur asnjë problem midis raporteve, qoftë nga ana e gjyqtarëve apo edhe e stafit administrativ. Janë disa çështje, disa sfida

që duhet t'i përfundojmë edhe në këtë gjykatë, por me rëndësi është që procesi i punës ka filluar dhe është funksional. Është bërë rekrutimi i 52 gjyqtarëve dhe po ashtu është bërë zgjedhja e kryetarëve të gjykatave. KGJK ka mbajtur 26 mbledhje dhe ka nxjerrë 379 vendime si dhe janë miratuar 10 rregullore, 2 udhëzime administrative lidhur me rishikimin e strategjisë kundër korrupsionit. Sa i përket komisionit për çështje normative, kam ka mbajtur 10 takime dhe i njëjti ka përgatitur draftin e 10 rregulloreve dhe tri udhëzimeve administrative. Ndërkaq, komisioni disiplinor, gjatë vitit të kaluar, në shqyrtim ka pasur 16 raste, 11 të vitit të kaluar dhe 5 që janë bartur nga viti paraprak dhe nga këto raste ka nxjerrë vendime, ku gjyqtarëve u janë shqyrtuar dy qortime, këto vendime kanë qenë lirim nga përgjegjësia, një vendim ka qenë qortim udhëzues për ndërmarrjen e veprimeve përgjuese, një vendim ka qenë ulje e pagës për 30 për qind, një vendim për uljen e pagës për gjashtë muaj 30 për qind, një për katër muaj, një vendim për suspendim dhe një rast është pushuar procedura disiplinore për sjellje të pahijshme.

Sa i përket komisionit për vlerësimin e performancës, ne për herë të parë, vitin e kaluar kemi filluar për vlerësim të performancës me një shtrirje më të gjerë të numrit të gjyqtarëve, për arsye se më parë, kryesisht gjyqtarët janë vlerësuar dhe ka qenë vlerësimi, ngritje në detyrë, ndërsa vitin e kaluar 66 gjyqtarë të të gjitha niveleve iu kanë nënshtuar vlerësimit të performancës dhe nga vlerësimi që është bërë për dy gjyqtarë është dhënë rekomandimi që ata t'i nënshtohen një trajnimit shtesë të gjyqtarëve. Po ashtu, edhe në këtë vit mbi 50 gjyqtarë do t'i nënshtohen vlerësimit të performancës, në bazë të formulës apo të zgjedhjes me short.

Sa i përket komisionit të personave të dënuar pa arsye, ka pasur 27 takime, janë shqyrtuar diku 153 raste dhe vlera e kompensimit të këtyre personave është 385 mijë e 470 euro. Po ashtu, paneli për lirim me kusht ka mbajtur 43 seanca dhe ka shqyrtuar 436 lëndë, d.m.th. personat që kanë kërkuar të lirohen me kusht, 215 prej tyre janë liruar, ndërsa janë refuzuar 211 raste. Sa i përket sfidave që ballafaqohet gjyqësori, në përgjithësi është numri i madh i lëndëve. Vërtet, kjo është një sfidë e madhe për ne, për arsye se lëndët presin në gjykatë me vite të tëra, për t'u zgjidhur apo qoftë në shkallën e dytë, për t'u vendosur e duhet prituri për vite të tëra. Kjo shkakton humbjen e besueshmërisë së publikut në organet e gjyqësisë. Gjendja më kritike është Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe në Gjykatën e Apelit, pavarësisht se vitin e kaluar ka zvogëlim të lëndëve. Më 1 janar të vitit 2017, në të gjitha gjykatat kanë qenë 372 mijë e 226 lëndë dhe ky numër ka zbritur, ku më 1.1.2018, kemi 273 mijë e 888 raste. Po ashtu, z. Idriçi shtoi se palëve iu intereson që rastet e tyre të zgjidhen brenda afatit të arsyeshëm, ashtu siç edhe e parasheh Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke pohuar se me angazhimin e 52 gjyqtarëve, të cilët në muajin shtator apo tetor, ata kanë të drejtë të marrin lëndë për gjykim, andaj shpresojmë që numri i lëndëve do të ulet edhe më shumë. Njoftoi se aktualisht është hapur konkursi edhe për 37 pozita, 7 prej tyre janë për pjesën veriore. Po ashtu, sfidë do të jetë edhe transparenca. Ne kemi filluar me publikimin e vendimeve në ueb faqe, nga 78 raste sa kemi pasur në fillim, tani kemi mbi 3000 aktgjykime të publikuara në ueb faqe të gjykatave dhe këtu shihet kualiteti dhe puna e secilit gjyqtar, por edhe opinionin e ketë qasje në vendime. Këtu ka pasur një debat se a duhet të publikohen edhe vendimet e shkallës së parë, që nuk janë të formës së prerë, mirëpo ka mbizotëruar mendimi, meqenëse

vendimet që nuk janë të formës së prerë dhe gjatë procedurave mund të ndryshohen, aktualisht publikohen vetëm vendimet e formës së prerë. Me këtë jemi munduar që ta rrisim transparencën dhe publiku të mund të shohë punën e çdo gjyqtari.

Po ashtu, si sfidë do të jetë edhe plotësimi i pozitave. Ne, aktualisht kemi 112 pozita shtesë, por kryesisht do të jetë staf mbështetës për gjyqtarë, sepse gjyqtarët nuk kanë pasur mbështetje, sa i përket stafit mbështetës, duke pasur vetëm nga një daktilograf. Diku 30 për qind e gjyqtarëve merren me punë administrative, në vend se me këtë çështje të merret një zyrtar ligjor apo bashkëpunëtori profesional. Me këtë numër, mendojmë që të zvogëlojmë numrin e lëndëve në gjykatë, që janë duke pritur. Një gjendje jo e mirë është dhe në Gjykatën e Apelit. Për fat të keq, një lëndë duhet të presë tri vite, ndoshta edhe më tepër, derisa të shqyrtohet në Gjykatën e Apelit. Dhe në këtë gjykatë, ne jemi munduar që ta forcojmë me numër të nevojshëm të gjyqtarëve për arsye se Gjykata e Apelit, pas Prishtinës, është në gjendje më kritike, sidomos në çështjet civile. Këtu, lëndët presin me vite të tëra, ndërsa lëndët në penale janë më mirë. Sa i përket gjykatave tjera, gjendja është më stabile dhe koha e vendosjes së lëndëve është pothuajse brenda afateve që parasheh ligji dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Ne e mirëpresim dhe vërejtjen tuaj, që në fund të raportit ta plotësojmë me rekomandime, këtë raport, se vërtet është e nevojshme, me qëllim të përmirësimit të efikasitetit dhe kualitetit të punës së gjyqtarëve.

Kryetarja, tha se sa i përket Komisionit për Legjislacion dhe bashkëpunimit që kemi me KGJK-në, kam dy vërejtje, në këtë drejtim, e para, shpesh ju shkruaj letra në raport me punën e komisionit dhe ndonjë informacion që lidhet për nevojat e komisionit dhe jo në të shumtën e herëve marr përgjigje zyrtare me shkrim. do të ishte mirë që kushdo që ju drejtohem si Komision për Legjislacion, të na drejtoheni zyrtarisht, me shkrim. Po ashtu, vërejtje ime është që të delegoni një përfaqësues që ta përcjellë punën e Komisionit për Legjislacion, pakon ligjore për sistemin e drejtësisë që është kompetencë e Komisionit për Legjislacion dhe për çështje tjera që ne organizojmë dëgjime publike, ku zakonisht përfaqësuesit e këtyre institucioneve të Kosovës janë të rëndësishëm, që të përfshihen në grupe të punës. Disa prej rasteve disiplinore, në të kaluarën janë parashkruar, që do të thotë se nuk keni pasur ndonjë mundësi që të ndërmerri masa ndaj gjyqtarëve, për shkaqe të parashkrimit dhe do ishte mirë të na njoftoni edhe sot se përse ndodh, a është për shkak të neglizhencës apo si ndodh që të parashkruhen rastet disiplinore. Ndërkaq, njëra prej anëtarëve të KGJK-së, është edhe Radojka Trifunoviç, që është deleguar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Lidhur me këtë, znj. Haxhiu pyeti: A është në përputhje me ligjin puna që bën në KGJK dhe a është e rregullt në mbledhjet e KGJK-së? Gjithashtu, shtoi se ka marrë shumë kritika për panelin me lirim me kusht dhe kritika më e madhe ka të bëjë për dyshimet për korrupsion dhe kërkoi sqarime se a është bërë një monitorim i punës dhe çështjeve të tjera. Janë ndarë afër 400 mijë euro për dënim, pa arsye. Lidhur me këtë, pyeti: A keni pasur ndonjë vlerësim apo analizë se pse kaq shumë ka raste të tilla të dënimeve pa arsye? A keni ndërmarrë ndonjë veprim konkret ose strategji të qartë se si mund të zvogëlohen lëndët nëpër Gjykata, sepse edhe pritja e qytetarëve është shumë e gjatë. Ndërkaq, znj. Haxhiu bëri një sqarim publik, sa i përket vendimit të Kryeministrit Haradinaj për pagat, vendimin e pagës së Kryeministrit, që prekte edhe

rritjen e pagës të kryesuesit të KGJK-së, ku tha se kemi marrë kritika, ne si deputetë, që kemi deponuar këtë vendim, në Agjencinë Kundër Korrupsionit, në Gjykatën Kushtetuese, për shkak se siç është thënë, nuk jemi për rritje të pagave të gjyqtarëve, të prokurorëve, gjë që nuk qëndron. Ne kemi kundërshtuar vendimin e paligjshëm të Qeverisë Haradinaj dhe kemi shprehur gatishmëri që kudo që ka ndonjë përpjekje për të rritur pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe stafit civil që më së shumti kanë nevojë për rritje të pagave, ne do të kontribuojmë në këtë drejtim, por natyrisht nuk do të mbështesim një vendim të paligjshëm, i cili tashmë është në Gjykatën Kushtetuese.

Ne kemi marrë pakon ligjore për sistemin e drejtësisë, njëri prej projektligjeve që ndryshohet është Projektligji i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe a keni qenë të përfshirë në draftimin e këtij projektligji, nëse jo, atëherë cili është qëndrimi juaj për të njëjtën? Po ashtu, së fundi kemi dëgjuar nga Ministria e Drejtësisë, që është duke punuar në procesin e rishikimit funksional për sistemin e drejtësisë. Cili është roli juaj si KGJK, në rishikimin funksional të sistemit të drejtësisë, dhe në këtë drejtim, cili është raporti i juaj me Ministrinë e Drejtësisë? Po ashtu, do t'ju sugjeroja që të respektoni mandatin tuaj kushtetues. Në procesin e dialogut, janë përfshirë edhe kryesuesit e KGJK-së dhe KPK-së, dhe në këtë drejtim, ne kemi marrë disa informacione se emrat e gjyqtarëve që janë integruar tashmë në sistemin e drejtësisë, janë rekomanduar në atë proces të dialogut me emra prej tyre ku këtu janë zhvilluar procedura formale, por njëra prej problemeve që ende s'kemi përgjigje zyrtare, ka të bëjë me pezullimin e lëndëve të reja dhe vlefshmëria e apelit, pra sipas informacioneve dhe dokumenteve që i kam para vetes, në këtë proces të dialogut është bërë njohja e gjykimeve të strukturave paralele të Serbisë në Kosovë, që kanë vepruar në kuadrin kushtetues të Serbisë. Domethënë, në këtë proces janë pranuar të gjitha aktgjykimet e strukturave paralele të Serbisë, ende sot askush s'e ka marrë përgjegjësinë për të thënë, nëse kjo është e vërtetë dhe në emër të Komisionit për Legjislacion, kërkoj sqarime në lidhje me këtë. Po ashtu, tash së voni, kemi dëgjuar për dorëheqjen e gjyqtarit Nikolla Kabashiq, a keni informacion, pse ka dhënë dorëheqje? E di që KGJK-ja nuk e ka pranuar dorëheqjen e të njëjtit, por a keni informacione më shumë për arsyet e dorëheqjes, po ashtu a keni njohuri për të kaluarën e tij? Sepse, ka pasur zëra të shumtë, sidomos nga qytetarët që jetojnë atje, që ka qenë pjesë e ndodhive që kanë ndodhur në vitin 2000-2001. Në fund, znj. Haxhiu pyeti se sa është numri i gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë, që duhen për t'i kryer detyrat dhe po ashtu sa është buxheti për vitin 2018, a është i mjaftueshëm për KGJK-në?

Nehat Idrizi, duke iu përgjigjur pyetjeve, tha se KGJK dhe KPK kanë një zyrë të përbashkët për mbrojtje disiplinore. Kompetencë kryesore e saj është që të iniciojë rastet disiplinore pranë komisioneve të KGJK-së, kur është fjala për gjyqtarë dhe pranë komisionit të KPK-së, kur është fjala për prokurorë.

Para se të ndryshojë ligji për KGJK-në, nuk ka pasur afat të parashkrimit, d.m.th. pavarësisht një gjyqtar, kur e ka bërë një shkelje të kodit të etikës apo e ka bërë një sjellje të pahijshme, prokurori disiplinor ka pasur të drejtë, në moment kur të informohet, ta paraqesë kërkesën e të iniciojë procedurën. Më pas, kanë filluar debatet në lidhje me këtë se a mund të lihet p.sh. një gjyqtar, meqë vepra si vepër penale po parashkruhet e vepra disiplinore mos të parashkruhet, në mënyrë

që mos të lihen peng gjyqtarët për vite të tëra, kurdo që t'i teket prokurorisë disiplinore të iniciojë procedurën dhe ka mbizotëruar mendimi, që mos të rrinë ata për vite të tëra duke pritur rastet, që kurdo që parashkruhen e kurdo mund ta ngrenë çështjen. Kjo ka qenë arsyeja kryesore që prokurorët të jenë më efikas, mos të pritët për vite të tëra, nëse një gjyqtar ka bërë një sjellje të pahijshme apo ka shkelur kodin e tij të etikës. Afati objektiv është pesë vjet, subjektiv është dy vjet, d.m.th. pesë vjet është nga momenti i kryerjes së shkeljes disiplinore, dy vjet është nga momenti kur njoftohet. Domethënë, ne si KGJK apo si komision disiplinor, nuk e kemi këtë kompetencë, këtë e ka Zyra e Prokurorit Disiplinor.

Sa i përket çështjes se dikush në forma të ndryshme ndikon tek gjyqtari, që një lëndë më e re të zgjidhet më shpejtë, një lëndë që pret me vite të tëra të jetë në pritje, atëherë ftoj që këto raste t'i paraqesin pranë Zyrës së Prokurorisë Disiplinore, që është i vetmi institucion kompetent që të iniciojë këtë procedurë. Pra, nëse është bërë shkelja e renditjes së lëndës dhe nëse një lëndë që është shumë më e re zgjidhet më shpejt e një lëndë pret me vite të tëra, këtu nuk ka trajtim të barabartë të lëndëve, por edhe të palëve. Sa i përket Panelit për Lirim me Kusht dhe dyshimet, ne i ftojmë të gjithë personat që kanë informacione, lirisht mund t'i paraqesin. Ky panel monitorohet nga një përfaqësues i EULEX-it, një kohë të gjatë dhe ombudspersoni e ka përfaqësuesin e vet që monitoron. Ka qenë i monitoruar edhe nga përfaqësuesi i Këshillit të Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, mirëpo ndërkohë, meqenëse kur është mbajtur seancë për votim, sa jam i informuar nga zyrtari i komisionit nuk është krijuar qasje kur është votuar d.m.th. nga komisioni, sepse procesi i votimit është çështje e mbyllur dhe në atë moment përfaqësuesi i KMLDNJ-së është tërhequr. Kam kërkuar sqarime dhe më është thënë se nuk i ndalohet monitorimi, por i ndalohet pjesa që ka të bëjë me votimin, se votimi është çështje e fshehtë, si proces. Për rastet e dënimit, pa të drejtë, e kam ngritur si çështje shqetësuese se vërtet ky numër po vjen duke u rritur dhe shuma po vjen duke u rritur, por për mua nuk është shuma aq shqetësuese, por më shumë është i dëmshëm për personat, pasojat që ata mund t'i kenë. U tha se diku 400 mijë është shuma që janë kompensuar për 353 persona që janë dënuar padrejtësisht në paraburgim. Aktivitetet që do ndërmerren, është njësi që i do t'i marrë të gjitha lëndët, për t'i shikuar, ku bëjnë një auditim dhe do të paraqesin një raport para KGJK-së, dhe nëse vërtetë konstatohet që një gjyqtar ka tri e më tepër vendime që kanë pësuar palët, atëherë ai duhet të dërgohet në komisionin për vlerësimin e performancës dhe pastaj ky komision ka kompetenca deri në propozimin për shkarkim. Nëse vërtet një gjyqtar merr një notë të pamjaftueshme, atëherë duhet nisur procedura për shkarkimin e tij.

Në ndërkohë, me këtë kontingjent të gjyqtarëve që janë rekrutuar, por edhe me ata që do të rekrutohen, mirëpo edhe me mbështetjen e stafit e bashkëpunëtorëve profesionalë, zyrtarëve ligjorë, afatet e stërzgjatura të lëndëve do të ulen. Sa i përket kësaj pjese, kemi nevojë për më tepër gjyqtarë dhe tani jemi në proces të rekrutimit të 32 gjyqtarëve, pasi të bëjmë plotësimin e vendeve të punës, me këto 112 pozita shtesë, atëherë do ta bëjmë një analizë dhe do të shohim se sa kemi nevojë që të rritet numri qoftë i gjyqtarëve, qoftë i zyrtarëve ligjorë. Sa i përket strategjisë, jemi duke përgatitur strategjinë me USAID-in, si të arrijmë që ta zvogëlojmë edhe më tepër grumbullimin e lëndëve. Ndërsa, në përfshirjen e projektligjit për KGJK-në, sqaroi se është

deleguar kryetari i komisionit për çështje normative në grupet punuese, që i ka caktuar Ministria e Drejtësisë, ku njëkohësisht ka qenë edhe kryesues i grupit punues. Këtu ndërlidhet edhe sistemi funksional në rishikimin e drejtësisë, që kemi pasur bashkëpunim dhe komunikim të shpeshtë për rishikimin e pakos ligjore të sistemit të drejtësisë. Dialogu ka filluar prej vitit 2013 – 2015 dhe u zvarrit deri vitin e kaluar, kur është bërë integrimi. Procesi i rekrutimit të gjyqtarëve është bërë nga një komision. Në këtë komision ka qenë ish-kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci, Valdete Daka dhe Nebojsa Boriçiq, nga Gjykata Supreme dhe dy gjyqtarë nga EULEX-i, të cilit kanë marrë pjesë në procesin e rekrutimit, i cili proces është bërë në pajtim me legjislacionin e Republikës së Kosovës. Janë integruar 39 gjyqtarë, pjesa më e madhe në Mitrovicë, ndërsa pjesa tjetër në komunat ku jetojnë shumica e komunitetit serb. Për informacionin tuaj, është një gjykatë që funksionon në dy objekte. Në pjesën veriore, në ish-objektin e Gjykatës së Qarkut, janë vendosur gjyqtarët nga lëmi penal, d.m.th. serbë dhe shqiptarë dhe stafi organizativ punon së bashku dhe në objektin e ish-Jugobankës, janë vendosur gjyqtarë nga lëmi civil, të dy komuniteteve dhe Departamenti për të Mitur.

Sa i përket vlefshmërisë së vendimeve që janë marrë nga ish- strukturat, ne kemi mbetur të formojmë një komision, për t'i shqyrtuar të gjitha lëndët, vendimet që janë nxjerrë, ku do të fillojë me rekomandimet e tij. Sa i përket Divizionit të Apelit, me marrëveshje parashihet, derisa të themelohet Divizion i Apelit, që është pjesë përbërëse e Gjykatës së Apelit në Prishtinë dhe kompetencë e këtij divizioni është që të vendosë lëndët në shkallë të dytë që vijnë nga komunat e rrethit të Mitrovicës. Sa i përket dorëheqjes së kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Rashiqit, pas vrasjes së Oliver Ivanoviçit, frika ka ekzistuar tek të dy palët, shqiptare që punon në veri dhe serbe që punon në jug, për shkak të situatës së krijuar. Gjyqtarët, pavarësisht situatës, asnjëherë nuk e kanë ndërprerë punën, kanë qenë d.m.th. edhe shqiptarët në veri dhe serbët në jug, nuk ka ndikuar kjo në raportet e tyre. Në dorëheqjen e ofruar, përmenden vetëm për shkaqe personale dhe nuk thellohet më detaje. Ndërkohë, 22 gjyqtarë nga komuniteti serb na drejtohen me një kërkesë ku ata shprehin shqetësimin, që nëse kryetari largohet, atëherë mund të vijë në pyetje funksionaliteti i kësaj gjykate. Pas kërkesave të shumta që janë bërë, ai është pajtuar që mos të dorëhiqet. KGJK-ja, në mbledhje, nuk ka miratuar dorëheqjen e tij, me arsyetimin se mund të rregullohet procesi, me vetë-deklarimin që gjyqtarët i drejtohen KGJK-së dhe paralajmërojnë, vihet në pikëpyetje funksionaliteti i gjykatës dhe ne kemi parë të arsyeshme që të vazhdohet me punë në këtë gjykatë. Duhet theksuar se komunikimi i tyre është shumë mirë, me një raport të ndër-ndërsjellët midis tyre. Sa i përket znj. Trajkoviç, më herët ka qenë pjesë e Komunes së Leposaviçit, ndërkohë me shkrim ka thënë që në momentin që është zgjedhur, nuk është e punësuar atje dhe ne aktualisht nuk kemi informacion që është duke punuar diku. Në takime merr pjesë, por jo e rregullt.

Hajdar Beqa, tha se megjithatë, duke pasur parasysh rolin që e luan sistemi i drejtësisë edhe në siguri, por edhe në integrim të vendit, ky raport është pasqyrim i drejtë edhe i të arriturave që i ka bërë sistemi gjyqësor, por edhe sfidat që i ka. Nëse e marrim punën e Këshillit, shihet që ka pasur shumë aktivitete, i kanë marrë 379 vendime dhe jam shumë optimistë që ato vendime kanë luajtur një rol të efikasitetit në gjykata, gjë që duket që ka avancim në raport me vitin 2016, sepse në vitin

2017 ka zvogëlim në numrin e lëndëve të përgjithshme 22.8 për qind, edhe pse kjo është e pamjaftueshme. Po ashtu, konsideroj që duhet të shikojmë mundësinë e rritjes së stafit dhe gjyqtarëve, që të zgjidhen këto probleme. Është për t'u vlerësuar edhe integrimi i sistemit gjyqësor, në pjesën veriore të Republikës së Kosovës, në bazë të marrëveshjes që është arritur në Bruksel. Mendoj që duhet të shikohet rruga ligjore që edhe komunitetet tjera të përfshihen atje, jo vetëm komuniteti serb. Sa i përket bashkëpunimit me sistemin e drejtësisë, kemi parë që angazhimi i ministrit të ri ka arritur që të ketë një buxhet më të mirë këtë vit, sesa vitin paraprak, që e konsideroj që është një vlerësim i mirë, por si sfidë kryesore është vonesa e zgjidhjeve të lëndëve. Shqyrtimi i të gjitha lëndëve, sidomos atyre civile, e humbin kuptimin, gjë që konsideroj që duhet të rritet mbikëqyrja apo kontrolli se a po zgjidhet sipas dorëzimit shkrimor. Ndërkohë, ka zëra që lëndët e vitit 2014, janë shqyrtuar para atyre të vitit 2012, nuk janë marrë në shqyrtim, se mund të merret lënda në shqyrtim e disa kanë prova për zgjidhje më të shpejtë e disa mund të vonohen. Por, z. Beqa pyeti: vonesa në lëndë, a ndikon dhe a është problem numri i vogël i gjyqtarëve apo është mosefikasiteti në punë, që bëjnë gjyqtarët dhe a është problem, mbase edhe buxheti i vogël? Po ashtu, do ishte mirë të na rekomandoni se çfarë mund të bëjmë si komision dhe si Kuvend, sepse jemi të interesuar të mbështesim drejtësinë, në veçanti, gjykatat. Më tej, z. Beqa tha se në fakt sistemi i drejtësisë është imazhi kryesor i shtetit, nëse kemi sistem të drejtësisë efikas, kemi mundësi për investitorë të jashtëm dhe të brendshëm, që të bëhet një siguri më e mirë.

Nehat Idrizi, tha se është sfidë e madhe që lëndët të zgjidhen brenda afatit të arsyeshëm dhe këtu besoj që edhe besueshmëria e publikut është në nivel jo të mirë. Ka edhe raste kur gjyqtarët që janë vonuar, i janë nënshtruar procedurës disiplinore, ka raste që janë propozuar edhe për shkarkim. Ligji ua mundëson, kur gjyqtari vjen në moment të shkarkimit, jep dorëheqje dhe s'mund të zhvillosh asnjë lloj procedure. Ndoshta, është një shans i mirë që edhe ju deputetët ta shikoni këtë mundësi, pasi gjyqtarët e kanë mundësinë e dhënies së dorëheqjes. Nuk përjashtohet mundësia që gjyqtarët, për shkak të neglizhencës dhe jo efikasitetit, nuk i ikim dhe asaj mund të bëhet ndonjë dobësi subjektive. Nëse pala, pas disa vitesh e humb një të drejtë, se ju thatë efektin, nuk ka efekt ai vendim gjyqësor, nëse kalojnë disa vite, gjendja faktike mund të ndryshojë dhe bëhet e parëndësishme, për këtë arsye është një sfidë e madhe që ne duhet të angazhohemi që lëndët të zgjidhen brenda afatit të arsyeshëm. Një ndër aktivitetet që kemi ndërmarrë, është shtimi i numrit të gjyqtarëve, plotësimi i pozitave të lira dhe rritja e stafit mbështetës me bashkëpunëtorë profesionalë dhe zyrtarë ligjorë. Nuk mjafton vetëm rritja e numrit, por gjyqtarët duhet të jenë më efikas në këtë drejtim.

Korab Sejdiu, tha se në Kuvend, aktualisht është në procedim e sipër Projektligji për gjykatat. Përveç, disa iniciativave të tjera që do të ndikojnë pozitivisht në sistemin e drejtësisë në vend, kam planifikuar që ndër të tjera të propozoj së paku dy amendamente në këtë ligj, edhe pse besoj se numri i amendamenteve përfundimtare që do t'i propozoj, do të jetë më i lartë, duke i cekur këto propozime.

Neni 34 PL- të amendamentohet në atë mënyrë që ta bëjë obligim ligjor që çdo gjyqtar të ketë së paku një bashkëpunëtor profesional, i cili është problem kyç në të gjitha nivelet.

Neni 30 i PL- të amendamentohet me një nen të veçantë në dispozita kalimtare, ashtu që të ketë rritje të menjëhershme prej 25% të pagave për gjyqtarë, deri në miratimin e një ligji të veçantë që bën nivelimin e pagave në sistemin publik, me ç' rast, do të hyjë në funksion neni 30 i PL, që është propozuar. Ky propozim është i arsyeshëm, sepse Kryeministri ka afirmuar kapacitetet buxhetore për një rritje shumë më të lartë, duke marrë vendimin për rritjen e pagave, prandaj kjo rritje është më e lehtë, më e menaxhueshme. Po ashtu, është në përputhje me qëllimin e Qeverisë, për të trajtuar dinjitetshëm gjyqtarët.

Rregullorja e Kuvendit i jep Komisionit për Legjislacion kompetencën që të “shqyrtojë çështjet e gjyqësisë në Kosovë” si dhe të “ushtrojë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës”. Në kuadër të këtyre kompetencave që ka ky komision, më duhet të theksoj vërejtjet si në vijim, lidhur me moszbatimin e plotë ose të pjesshëm të disa dispozitave ligjore nga gjyqtarët që veprojnë në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës, duke filluar me Ligjin për procedurë kontestimore:

Nenet 400-410 të LPK-së, përcaktojnë qartë procedurën për seancën përgatitore, që në fakt, ndërlihet edhe me parimin e ekonomizimit të procedurës dhe trajtimit ekspeditiv të lëndëve para gjykatës. Është më se e qartë, se një pjesë e madhe e gjyqtarëve nuk zbatojnë plotësisht këto obligime ligjore, me ç' rast, mungon adresimi ekspeditiv i lëndëve, duke krijuar vonesa të panevojshme në trajtimin e lëndëve.

Nenet 197, 200 dhe 201 të LPK-së, trajtojnë çështjen se kur duhet Gjykata e Apelit të vendosë vetë apo të kthejë çështjen për rigjykim në shkallë të parë. Fatkeqësisht, një analizë e rasteve që trajton Gjykata e Apelit, shfaq shkelje të vazhdueshme dhe kronike të këtyre dispozitave, me ç' rast, pjesa dërmuese e lëndëve kthehen në rivendosje pa nevojë, edhe kur Gjykata e Apelit mund të vendoste vetë. Kjo dëmton palët, shkakton vonesa të panevojshme, krijon punë shtesë dhe ngarkon pa nevojë resurset e gjykatave. Pra, këto dispozita të LPK-së, si më sipër, nuk po zbatohen në përputhje me tekstin dhe qëllimin e ligjvënësit.

Sa i përket Kodit të Procedurës Penale, Neni 463 i KPPK-së i jep gjyqtarit penalist të drejtën të merr vendim mbi kërkesën pasurore-juridike të palës së dëmtuar. Dhe në pjesën dërmuese, pothuajse gjithmonë, gjykata penale udhëzon palën në kontest civil, duke krijuar dy ose më shumë lëndë nga një lëndë e vetme. Po ashtu, dërgon lëndët nga një gjyqtar që njeh çështjen shumë mirë dhe me lehtësi mund të vendosë për kërkesën pasurore-juridike, tek gjyqtarë të tjerë që duhet analizuar rastin nga zanafilla, duke humbur efikasitet. Pra, një diskrecion që i jepet gjykatës penale, po abuzohet dhe Neni 463 i KPPK-së nuk po zbatohet, ashtu si është menduar nga ligjvënësi. Gjithashtu, Ligji për konfliktet administrative: Neni 42.3 i LKA-së lejon Departamentin Administrativ të vendosë vetë për rastin në procedurë administrative, pra të nxjerrë vendim vetë. Në Departamentin Administrativ është krijuar praktika që në tërësi injoron këtë diskrecion, dhe të gjitha rastet fillimisht i kthen në rivendosje dhe vendos vetë, vetëm kur nuk ka të drejtë më ta kthejë në rivendosje. Prandaj, në të gjitha rastet ndodh loja e pingpongut me qytetarët, ku vendosë gjykata për kthim për rivendosje në administratë dhe qytetari abuzohet, duke ecur në procedura administrative dhe konflikte administrative për vite me radhë, kur i tërë rasti mund të përfundonte herën e parë, para gjykatës. Ky injorim i tërësishëm i kësaj dispozite nga gjykata është edhe shkelje e Nenit 31 të Kushtetutës dhe Nenit 6 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, që garanton gjykim të drejtë dhe të paanshëm, brenda një kohe të arsyeshme. Pra, injorimi i këtij diskrecioni për të vendosur vetë gjykata, kur i ka të gjitha informatat, abuzon qytetarët, stërzgjat procedurat,

ngarkon gjykatat dhe administratën me lëndë shtesë dhe cenon ekonomizimin e procedurës. Mbi të gjitha, shkel të drejtat e njeriut që iu garantohen qytetarëve të Republikës së Kosovës. Neni 46 i LKA-së i jep mundësinë Departamentit Administrativ, që të bëjë kompensimin e dëmit. Edhe këtu, kjo nuk ndodh, pothuajse kurrë dhe palët vazhdimisht udhëzohen në kontest civil, duke krijuar dy ose më shumë lëndë nga një lëndë e vetme dhe kjo vetëm pasi të ketë përfunduar pingpongu me qytetarin. Dhe pas 8-9 viteve ose më shumë, qytetari i duhet të bëjë padi në departamentin e përgjithshëm, ku me gjasë do të presë 3-4 vite vetëm që të fillojë rasti civil. Po ashtu, dërgon lëndët nga një gjyqtar që njeh çështjen shumë mirë dhe me lehtësi mund të vendosë për kompensimin e dëmit, te gjyqtarë të tjerë që duhet analizuar rastin nga zanafilla, duke humbur efikasitet. Për më tepër, heq përgjegjësinë e administratës, sepse gjasat janë që kur të kryhet lënda, një pjesë e vendimmarrësve të kundërligjshëm nuk janë në pozitë apo edhe gjallë. Pra, një diskrecion që i jepet gjykatës administrative, po abuzohet dhe Neni 46 i LKA-së nuk po zbatohet, ashtu si është menduar nga ligjvënësi

Sikur këto dispozita të zbatoheshin nga gjykatat, ashtu si është paramenduar nga ligjvënësi, besoj se do të ndikonin drejtpërdrejt edhe në zvogëlimin e lëndëve të grumbulluara në gjykata. Por çka është më me rëndësi, do të trajtonin qytetarin me dinjitet, do të shqyrtonin lëndët e qytetarëve më shpejt, nuk do të cenoheshin të drejtat e qytetarëve për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dhe mbi të gjitha, do të fillonin kthimin e besimit në gjyqësor.

Shpresoj që t'i merrni parasysh këto shqetësime që ngrita dhe të ndërmerri hapa konkretë për vetëdijesimin e gjyqtarëve përkatës për obligimet ligjore që i kanë në përputhje me legjisllacionin që trajtova sot. Propozimet, si më sipër, besoj se do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në zvogëlimin e lëndëve dhe ngritjen e kapacitetit të gjyqtarëve, për të adresuar më shumë lëndë, në mënyrë më kualitative.

Gjatë mandatit tim, sistemi i drejtësisë do të më ketë një aleat të fuqishëm në Kuvend, por njëkohësisht, pres nga ju të mirëkuptoni edhe vërejtjet serioze që do t'ia bëjë gjyqësorit gjatë mandatit tim, brenda kompetencave që kemi.

Nehat Idrizi, Sa i përket çështjes së rivendosjes në bazë të statistikave që i kemi, diku 80 për qind të rasteve, në shkallë të dytë, prishen lëndët dhe kthehen në rigjykim dhe pajtohem me këtë çështje që e shtrove. Në bazë të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës kontestimore, Gjykata e Apelit ka të drejtë dy herë ta kthejë lëndën, por do ishte mirë që vetëm një herë ta kthejë, që herën e dytë të vendosë vetë dhe me këtë kufizim zvogëlohet stërzgjatja e procedurës. Kur ka prova, gjyqtari duhet të vendosë edhe për kërkesën pasurore juridike. Sa i përket Ligjit të konfliktit administrativ, gjyqtari nuk guxon të vendosë në bazë të praktikës, nëse ligji e përcakton se si duhet të vendoset, sepse praktika bie poshtë. Ne kemi bërë një plan të veprimit dhe kemi vendosur një prioritet që këto lëndë të vendosen në një afat sa më të shkurtër, sepse ankesat më të mëdha i kemi te zvarritja e lëndëve nëpër gjykata.

Arben Gashi, tha se në bazë raportit që pashë, nuk gjeta statistika që kanë të bëjnë me sistemin gjyqësor dhe në bazë të këtyre statistikave të bëhet një analizë krahasuese me vendet tjera. Sa është numri i stafit gjyqësor dhe i stafit jo gjyqësor në Kosovë për 100 mijë banorë në Kosovë? Po ashtu, më intereson ta di numrin e lëndëve të zgjidhura për gjyqtar dhe numrin e lëndëve të secilit gjyqtar, numrin e lëndëve të vjetruar për gjyqtar. Gjithashtu, a keni bërë analizë për të parë se cili gjyqtar po punon apo nuk po punon? Nëse i marrim vendet e rajonit, numrin e gjyqtarëve për 100 banorë i kanë 40-50 gjyqtarë, në vendet e Bashkimit Evropian është 15-20 gjyqtarë. Më tej, z. Gashi tha

se do duhej një analizë e tillë e sistemit gjyqësor, në mënyrë që të gjendet diagnoza e saktë e problemit, sepse do ta kemi shumë të lehtë për ta gjetur zgjidhjen. Po ashtu, sa është numri i lëndëve që i rrëzohen një gjyqtari, sepse nëse përqindja është e lartë, atëherë ai nuk është duke e bërë punën.

Nehat Idrizi, tha se gjyqtarët e secilës lëmi, në fund të muajit, dorëzojnë raportin me shkrim se sa lëndë i kanë kryer brenda muajit, por edhe Gjykata e Apelit, kur jep raportin, dihet se cilit gjyqtar i është prishur lënda. Gjykata Themelore në Prishtinë dhe Gjykata e Apelit janë më shumë të ngarkuara me lëndë sesa gjykatat tjera, duke pohuar se një gjyqtar në lëmin civil të Prishtinës ka diku 1000 lëndë. Më tej, z. Idrizi tha se do t'ua përcjellë me shkrim raportin më të hollësishëm, me statistikat e kërkuara.

Igor Simiq, i falënderoi për procesin e integritetit për gjyqtarët në veri. Nuk ka pasur asnjë problem në periudhën paraprake, kur ka filluar ky proces, por është fakt se qytetarët e ndershëm nuk do kenë kurrë problem as me gjyqësi, as me polici. Sugjerimi është se me lëndët e vjetra dhe sa është prezent çështja e ndërmjetësimit dhe arbitrazhit dhe a i pranojmë ne disa projekte nga USAID-i, të zgjidhjes të mosmarrëveshjeve, në mënyrë që të lehtësojmë punën e gjyqeve.

Nehat Idrizi, tha se me ndihmën e disa projekteve të USAID-it dhe UNDP-së, jemi duke ndërmarrë disa aktivitete që numri i madh i lëndëve të zgjidhet me ndërmjetësim, sepse edhe gjykatat shkarkohen nga ngarkesa e lëndëve. Me ndërmjetësim, palët janë të kënaqur, fitohet kohë dhe nuk ka zvarritje të lëndëve, por edhe fuqia e vendimit është e njëjtë si e gjykatës. Sa i përket arbitrazhit, kemi Departamentin Ekonomik, në kuadër të Gjykatës Themelore dhe të Apelit dhe kjo varet nga vullneti i biznesit se procesin a duan ta zgjidhin në rrugë gjyqësore apo përmes arbitrazhit. Ne nuk kemi të dhëna të sakta se sa palë kanë dashur që të zgjidhin rastet e tyre, përmes arbitrazhit.

Nezir Çoçaj, tha se ju përgëzoj për punë e bërë dhe në bazë të dhënave që ju potencuat, duket qartë që është më mirë se viti paraprak. Edhe fakti se janë rekrutuar 52 gjyqtarë, ndërkohë që pritet rekrutimi edhe 37 gjyqtarëve të tjerë dhe hapjen e konkursit për 112 të stafit, dukshëm do të zbutet mungesa e stafit që ka mbizotëruar në punën e gjyqësorit që do të përmirësojë në zgjidhjen e lëndëve në gjykata. Një lëndë, a mund t'i ketë disa numra dhe a janë të përfshira këto lëndë në numrin 273 mijë lëndë? Po ashtu, kriteret për vlerësim të performancës së gjyqtarëve i ka caktuar komisioni apo Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mënyrë që secili gjyqtar të ketë një vlerësim të mirëfilltë të performancës, për secilin gjyqtar.

Nehat Idrizi, sqaroi se 50% e lëndëve, janë lëndë për kundërvajtje, të cilat e rrisin këtë numër. Çdo vit 1/3 e gjyqtarëve do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit të performancës. Këtë vit janë 53 gjyqtarë për vlerësim të performancës. Kriteret janë të përcaktuara në ligj dhe në Rregullore dhe masa më e ulët është detyrimi, trajnimi shtesë dhe masa më e rëndë është propozimi për shkarkim.

Kryetarja pyeti për lëndët e transferuara të EULEX-it, se a kanë kapacitete të mjaftueshme për t'u marrë me këto lëndë, po ashtu edhe për lëndët e korrupsionit që po paraqesin problem, dhe për më tepër, është absurde të thuhet që po luftojmë korrupsionin, sepse është vendosur kusht për liberalizim të vizave, ndërkohë që ne do duhej ta luftonim vetë korrupsionin, për shkak të shtetit të së drejtës dhe interesave të qytetarëve. Në të shumtën e rasteve, ka dënime me kusht, por shqetësuese është se këto raste edhe po parashkruhen dhe a është e rëndësishme që të rishikohet pakjoja ligjore kundër korrupsionit dhe konkretisht barra e provës, e cila aktualisht i takon

prokurorit, por ndoshta do ishte mirë të zëvendësohet, që barra e provës t'i mbetet të pandehurit, ku ai duhet të dëshmojë se ku e ka krijuar pasurinë.

Agim Maliqi, sa i përket çështjeve që ngriti znj. Haxhiu, ne si komision nuk mund të ndërhyjmë në vendimmarrje të gjyqtarëve, në mënyrën e zgjidhjes së lëndëve. Nga 212 lëndë, që janë zgjidhur vitin e kaluar, 35 janë të shqiptuara dënime me burgim, 42 janë dënim me gjobë, 32 dënim me kusht apo dënim alternativ, 53 raste të aktgjykimeve liruese, 12 raste refuzuese dhe 37 raste pushim të procedurës penale. Raste të parashkrimit nuk kemi evidentuar për rastet e korrupsionit.

Bahrim Shabani, shqetësim i z. Shabani ishte se asnjë nga radhët e komuniteteve tjera nuk është emëruar gjyqtar apo prokuror në gjykatën dhe prokurorinë, si pjesë e integritit të veriut. Pyeti se a është kjo pjesë e Marrëveshjes së Brukselit, duke pohuar se komunitetet tjera janë të diskriminuara dhe të lënë anash, gjatë këtij procesi. Po ashtu, nga 37 pozita për gjyqtarë, 7 pozita janë nga komunitetet, a keni paraparë në këto 7 pozita të ketë edhe nga komuniteti boshnjak dhe goran?

Pas diskutimeve, komisioni vendosi që të presë edhe raportet plotësuese dhe më pas ta adresojë raportin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për projektligjin nr. 06/L-039 për Shërbim Gjeologjik të Kosovës dhe ftoi anëtarët e komisionit të deklarohen për ndonjë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-034 për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 05/L-080

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-034 për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 05/L-080 dhe ftoi anëtarët e komisionit të marrin fjalën, nëse kanë vërejtje.

Arben Gashi, tha se nuk është parataktikë e mirë që projektligjet të jenë plotësim-ndryshim 2 apo 3 herë, ku krijohet konfuzitet te zbatuesit e ligjit. Po ashtu, çështja e privatizimit është e ndjeshme në aspektin e menaxhimit dhe funksionimit të saj, sidomos në qëllimin e projektligjit.

Korab Sejdiu, tha se nëse e miratojmë këtë raport, duhet t'i miratojmë ato amendamente që kanë mbështetjen e Komisionit Funkcional dhe jo ato që nuk kanë mbështetje. Po ashtu, është një nen në këtë ligj që i jep të drejtën agjencisë që me kërkesë të urdhërojnë policinë që të ndërmarrin veprime, për çka mendoj se është cenim i të drejtave kushtetuese që i kanë gjyqtarët për gjykim të drejtë, pasi që policia vepron vetëm sipas urdhrin të gjykatës dhe prokurorisë.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni, me dy vota për, të z. Hajdar Beqa dhe z. Bilall Sherifi, një kundër e znj. Albulena Haxhiu dhe 3 abstenime të z. Bahrim Shabani, z. Arben Gashi dhe z. Korab Sejdiu, nxori këtë:

Rekomandim

1. Komisioni nuk e përkrah raportin me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 05/L-080.

6. Të ndryshme

Kryetarja, tha se më dt. 2.3.2018, komisioni është mbledhur për mbledhje të jashtëzakonshme, por nuk ka pasur kuorum, për të diskutuar për shkeljen e Rregullores së Kuvendit nga ana e Kryetarit të Kuvendit.

Nga anëtarët e komisionit, të cilët nuk ishin prezent në mbledhjen e jashtëzakonshme, u tha se kërkesa për mbledhje të jashtëzakonshme nuk ka pasur urgjencën e nevojshme.

Po ashtu, u diskutua edhe për Projekt-Rregulloren e Kuvendit, e cila nuk është pikë e rendit të ditës në seancën e radhës dhe arsyeja ishte se ka mbetur edhe një herë që të diskutohen disa çështje dhe nëse nuk ka pajtueshmëri mes grupeve parlamentare, do të mbetet Rregullorja aktuale.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Albulena Haxhiu